



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.495/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Bibita” ShPK me numër të biznesit 810746737 dhe seli në fshatin Vitomericë në Pejë, kundër debitorit “The North Unicorn” LLC me NUI 810112186 dhe seli në zonën industriale në Prishtinë, i cili përfaqësohet sipas prokurës nga avokati Arianit Koci me seli rrugën Robert Doll nr. 19 në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.523/23 të datës 29.12.2023 me datë **07.06.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e kreditorit “Bibita” ShPK, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.523/23 të datës 29.12.2023 **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.523/23 të datës 29.12.2023 në pikën I të dispozitivit të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit të përmbartimit “The North Unicorn” LLC me NUI 810112186 dhe seli në Prishtinë dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.36/2022 i datës 12.04.2022 i përmbartuesit privat Fatos Shatri me seli në Istog, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka detyruar kreditorin që brenda afatit prej shtatë (7) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj debitorit shpenzimet e procedurës të shkaktuara në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë prej 156.00€, në emër të përpilimit të prapësimit nga avokati.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.523/23 të datës 29.12.2023, apo ndryshohet apo lënda të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Bibita” ShPK, ka paraqitur propozimin për përmbartim me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori “The North Unicorn L.L.C” NUI 810112186 dhe të dhëna tjera si në hyrjen e këtij aktvendimit që t’ia paguaj shumën prej 11,822.70€ dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Propozimin për përmbartim e kishte bazuar në faturat nr. 061621020-1 të datës 16.06.2021, nr.062121014- 1 të datës 21.06.2021, nr.063021004-1 të datës 30.06.2021, nr.070721002-1 të datës 07.07.2021, nr.071521015-1 të datës 15.07.2021, nr.090121001-1 të datës 01.09.2021, faqja 2 nga 5 nr.090321014-1 të datës 03.09.2021, nr.090721002-1 të datës 07.09.2021, nr.091621023-1 të datës 16.09.2021, nr.100621024-1 të datës 06.10.2021, nr.101421002-1 të datës 14.10.2021, nr.102821028-1 datës 28.10.2021, nr.11101011-1 e datës 10.11.2021, dhe nr.111221004-1 të datës 12.11.2021 të lëshuar nga ai për Debitorin të cilat në kopje me ngjyrë ia ka bashkëngjitur Propozimit. Përmbartuesi më 12.04.2022 e ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.36/2022 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit.

Debitori më 20.04.2022 ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor. Ai ka deklaruar se Propozimi mbështetet në fatura të cilat nuk i plotësojnë kushtet ligjore, pasi ato janë të panënskruara dhe të pavulosura. Tutje shton se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet ligjore që dalin nga neni 29 paragrafi 3 i LPP-së si dhe neni 20 (1.1.17) të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010. Gjithashtu thekson se përtej parregullsive të faturave, ai parashtron se me Kreditorin krahas kontratës, kishin nënshkruar edhe Shtojcën nr.1, në të cilin ishin dakorduar për vlerën e saldosh në lartësi prej 1,952.00€, sipas dakordimit në këtë shtojcë, vlera e saldosh, do të paguhej në momentin kur zgjidhet kontrata mes palëve, e duke qenë se kontrata në fjalë ende nuk është zgjidhur, atëherë kjo vlerë ende nuk është bërë e arritshme. Përveç kësaj, ka deklaruar se ka bërë pagesa në favor të Kreditorit, prandaj shuma e kërkuar nuk përkon me borxhin eventual që mund ta ketë ndaj tij. Në fund ka cekur se nëse zbritet vlera e faturave të panënskruara dhe të pavulosura, të cilat arrijnë vlerën prej 9,429.06€, nga shuma prej 11,822.70€ e kërkuar me Propozim, atëherë në rastin më të mirë për Kreditorin del se borxhi do të mund të ishte në lartësi prej 1,493.7€, shtu këtu se vlera e saldosh e cila nuk është bërë e arritshme. Prapësimit ia ka bashkëngjitur si provë shtojcën nr.1 për kushtet specifike për blerjen dhe kthimin e mallrave dhe tri dëshmi të pagesave në favor të Kreditorit nga 500€ secila, ndërsa e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale për paraqitjen e Prapësimit përmes avokatit në shumë prej 156€.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka kërkuar që prapësimi të refuzohet si i pabazuar dhe të lihet në fuqi Urdhri. Ai ka pretenduar se për secilën faturë ekziston dëshmia e pranimit të mallit. Sipas tij, afati i pagesës ka qenë 60 ditë, të cilit Debitori nuk i është përmbajtur, rrjedhimisht janë plotësuar kushtet që të kërkohet përmbushja e tyre. Shton se pagesa e Debitorit prej 1,500.00€ e përmendur në Prapësim është zbritur nga shuma totale e borxhit të tij, siç vërtetohet nga kërkesa e datës 26.01.2022 e nënshkruar dhe e vulosur për konfirmim të llogarive të pagueshme në të cilin edhe vet debitori e ka pranuar borxhin prej 13,322.71€. Gjithashtu cek se Debitori ka bërë pagesa pa e cekur faturën të cilën e ka paguar. Përgjigjes në prapësim nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë, ndërsa nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale për paraqitjen e përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.523/23 të datës 29.12.2023, në pikën I të dispozitivit të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit të përbarimit “The North Unicorn” LLC me NUI 810112186 dhe seli në Prishtinë dhe ka shfuqizuar urdhrin përbarimor P.nr.36/2022 i datës 12.04.2022 i përbaruesit privat Fatos Shatri me seli në Istog, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka detyruar kreditorin që brenda afatit prej shtatë (7) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj debitorit shpenzimet e procedurës të shkaktuara në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë prej 156.00€, në emër të përpilimit të prapësimit nga avokati.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se Kreditori Propozimit ia ka bashkëngjitur faturat lëndore në kopje me ngjyrë dhe të pa vërtetuara te noteri, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova nga të cilat rrjedhë se Përbaruesi e ka ftuar Kreditorin që të bëjë ndonjë përmirësim në Propozim ose të dorëzoj ndonjë provë ose shkresë.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përbaruesit privat, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përbarimi është lejuar në bazë të faturave të lartcekura të cilat nuk janë në origjinal, ose kopje e vërtetuar të dokumentit të besueshëm. Këto fatura nuk kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm konform nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së dhe si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përbarimit.

Faturat që janë bazë për lejimin e përbarimit nuk përmbajnë elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, i cili përcakton se: *“Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* si dhe është në pajtim me nenin 37 të LPP-së i cili thotë se *“kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Prandaj, bazuar ne këto arsye, Gjykata e shkalles së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkalles se dytë.

Gjykata e Shkallës së Dytë vlerësoi pretendimet ankimore të kreditorit kur ka theksuar se faturat dhe dëshmitë e mallit janë të nënshkuara dhe të vërtetuara të noteri mirëpo pretendimet e tilla nuk ndikuan në vendosjen ndryshe pasi që vërtetimin e faturave ma akt noterial kreditori e ka dorëzuar me ankesë ndërsa në procedurën përmbartimore, këto të meta duhet të evitohen para se të nxirret urdhri përmbartimor e jo në fazën e më vonshme kur gjykata e bënë shqyrtimin e prapësimit ashtu siç parashihet me nenin 38 par 2 të LPP-së.

Sipas kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.495/24 me datën 07.06.2024,**

**Gj y q t a r i,**  
**Faton Bajrami**